



<http://www.abek.org>

ASOCIACIONI TË BIBLIOTEKAVE ELEKTRONIKE TË KOSOVËS
ASSOCIATION OF ELECTRONIC LIBRARIES OF KOSOVO



REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA E KOSOVËS	
AKADEMIA E DREJTËSISË	
AKADEMIJA PRAVE - ACADEMY OF JUSTICE	
Njësia, Org. Org. Jedin. Org. Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No. 150/2020
Nr. Faqeve Br. Stranica No. Pages	Data Datum Date 16.06.2020
Prishtinë / a	

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

MIDIS

ASOCIACIONIT TË BIBLIOTEKAVE ELEKTRONIKE TË KOSOVËS

DHE

AKADEMISË SË DREJTËSISË

Kjo marrëveshje është arritur në Prishtinë më 16.06.2020, ndërmjet

Asociacionit të Bibliotekave Elektronike të Kosovës (tash e tutje ABEK), në një rën anë dhe

Akademisë së Drejtësisë (tani e tutje AD), në anën tjetër.

Në pajtim me këtë marrëveshje palët nënshkruese u morën vesh, si në vijim:

Neni 1

Qëllimi i marrëveshjes

Qëllimi i kësaj marrëveshje është anëtarësimi i Akademisë së Drejtësisë në Asociacionin e Bibliotekave Elektronike të Kosovës dhe shfrytëzimi i burimeve dhe materialeve elektronike të nevojshme për AD-në, që i ofron ABEK-u.

Neni 2

Anëtarësimi i AD-së në ABEK ofron mundësinë e shfrytëzimit të burimeve elektronike të cilat sigurohen nga ABEK përmes EIFL.

Neni 3

AD obligohet që në emër të anëtarësimit në ABEK të paguajë shumën vjetore në vlerë prej 200 € (dyqind euro) që nga momenti i hyrjes në fuqi të marrëveshjes e cila paguhet në llogarinë rrjedhëse të ABEK-ut me nr.1117001575000178 , në bankën: Pro Credit Bank.

Neni 4

Çështjet e abonimit për burimet elektronike me pagesë dhe të vëllimit të shfrytëzimit të tyre do të rregullohen me aneks-marrëveshje të veçantë.

Neni 5

ABEK mban kontakte të vazhdueshme me anëtarët për informim rreth aktiviteteve, nevojave, prioriteteve dhe synimeve, si dhe u përgjigjet atyre.

Neni 6

AD mban kontakte të vazhdueshme për informim me zyrën qendrore të ABEK-ut rreth aktiviteteve, nevojave dhe synimeve të bashkëpunimit reciprok në nivel vendor, rajonal dhe ndërkombëtar.

Neni 7

ABEK prezanton dhe përkrahë interesat e anëtarëve të tij në nivel të organizmave vendor dhe në nivele të tjera.

Neni 8

ABEK krijon mundësitë për shfrytëzimin e burimeve elektronike të nevojshme për AD-në, përmes trajnimeve dhe botimeve me interes.

Neni 9

Marrëveshja nënshkruhet në 2 (dy) kopje që nënkupton nga një për palët kontraktuese

Neni 10

Marrëveshja hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët dhe zgjat për aq sa palët kontraktuese kanë interes dhe përmbushin obligimet që dalin nga marrëdhëniet kontraktuale.

Neni 11

Kjo marrëveshje shkëputet me paralajmërim 30 ditë para pagesës së rregullt vjetore nëse ABEK nuk ofron informacione për të rehat rreth burimeve elektronike që ofron.

Akademia e Drejtësisë

Drejtori Ekzekutiv
Enver Fejzullahu

Data: 16.06.2020

Asociacioni i Bibliotekave Elektronike të Kosovës

Koordinatorë:
Bukurije Haliti

Data: 16.06.2020

ANEKS I MEMORANDUMIT TË BASHKËPUNIMIT MIDIS ASOCIACIONIT TË BIBLIOTEKAVE ELEKTRONIKE TË KOSOVËS DHE AKADEMISË SË DREJTËSISË

Bazuar në marrëveshjen e arritur të dt. 16.06.2020 mes dy palëve kontraktuese, ABEK-ut dhe AD-së, në këtë aneks janë të përshkruara data bazat elektronike që janë të qasshme për AD-në si në vijim:

1. Publikimet Edward Elgar
2. Revistat online të Cambridge
3. Autoritetet shkencore të Oksfordit për të drejtën ndërkombëtare Oxford Reference Online
4. Enciklopedia e Max Planck për të Drejtën Publike Ndërkombëtare
5. OECD-iLibrary
6. IOPscience
7. eBiblioteka e Fondit Monetar Ndërkombëtar

Përveç këtyre data bazave, si rezultat i rrethanave të krijuara nga pandemia Covid 19 janë të qashme edhe një listë e konsiderueshme e burimeve elektronike e lëshuar për përdorim nga ICOLC (International Coalition of Library Consortia)

Burimet të cilat sigurohen pa pagesë përmes EIFL-as mund të ndërrojnë në vite prandaj, ABEK është i obliguar të njoftojë AD-në për ndryshimet eventuale që bëhen në këtë listë të bazës së të dhënave.

Akademia e Drejtësisë

Drejtori Ekzekutiv

Enver Fejzullahu




Data: 16.06.2020



Asociacioni i Bibliotekave Elektronike të Kosovës

Koordinatorë:

Bukurije Haliti



Data: 16.06.2020

